

EPPC Albania kërkon një *Operational Manager* për klientin e saj, **rrjet i suksesshëm dyqanesh (Beauty & Care)**, pjesë e një prej grupeve lider dhe të konsoliduar në treg në fushën e marketingut & distribucionit.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Përcjell në baza ditore dhe është përgjegjës për operacionet e kompanisë;
- Drejton, mbikqyr, motivon dhe zhvillon stafin me qëllim përmirësimin e performancës së tyre në punë dhe sigurimin e përmbushjes së objektivave të përcaktuar;
- Monitoron aktivitetet e shërbimit ndaj klientit, me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor dhe të kënaqshëm për ta;
- Kujdeset për rritjen e efikasitetit të punës në shitjen e produkteve dhe rritjen e prezencës së kompanisë/BRAND-it në treg;
- Monitoron nivelet e inventarit me qëllim përcaktimin e nevojave për furnizim nëpër dyqane;
- Vendos dhe rregullon cmimet e produkteve, bazuar në rezultatet e analizave, studimeve dhe kërkesave të tregut;
- Krijon, zhvillon dhe mban marrëdhënie të mira me klientët dhe aktorët e tjerë në treg;
- Vlerëson dhe analizon të dhënat operative dhe financiare për të përcaktuar ecurinë e shitjeve;
- Kujdeset për realizimin e objektivave të vendosura nga kompania;
- Raporton në mënyrë periodike mbi bazën e standardeve të vendosura nga kompania.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Arsim i lartë; (*Fakulteti Ekonomik përbën avantazh*)
- **Përvojë e mëparshme jo më pak se 3 vjet në pozicione të ngjashme drejtuese; (eksperienca në retail-i përbën avantazh)**
- Të zotërojë shumë mirë **gjuhën Angleze** dhe paketën MS Office; (**Excel**)
- Aftësi shumë të mira drejtuese, analitike, organizative dhe komunikuese;
- **Të zotërojë leje drejtimi;**
- Të jetë person i përgjegjshëm, me integritet dhe dëshirë për të punuar.

Të dhënat:

Pozicioni:	Operational Manager;
Vendndodhja:	Tiranë;
Pagesa:	Në nivel drejtuesi;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	20.08.2017.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail-it:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.